

Ballkani: dy modele politikash gjuhësore

Në fjalorin politik termi “ballkanizim” përdoret për të karakterizuar politikat çintegruese që shpien në copëtim të shkallëshkallshëm të njësive gjeografiko-politike më të mëdha në njësi më të vogla joefektive dhe shpesh armiqësore me njëra-tjetrën. Ky proces ndarjeje, që shkon kundër prirjes së përgjithshme integruese, përbën me të vërtetë një karakteristikë shekullore tipike për sllavët e gadishullit tonë, të cilët që nga koha e nguljes së tribuve sllave në trevat e Ballkanit (aty nga shek. VI–VII) i janë nënshtruar një procesi diferencimi që duket se po merr fund në ditët tona. Në fazën e parë të këtij procesi, që mund të vendoset në kapërcyell të mijëvjeçarit të parë, tributë sllave u diferencuan në sllovenë, kroatë, serbë e bullgarë; në mesin e shek. XX, këtij grupi iu shtuan edhe maqedonët, në fund të këtij shekulli boshnjakët; dhe, me referendumin për pavarësi të Malit të Zi, listës së shteteve sllave të Ballkanit po i shtohen edhe malazezët.

Por duhet thënë se ballkanizmi nuk është modeli i vetëm i zhvillimeve politike, shoqërore dhe kulturore për gadishullin tonë. Në Ballkan ka vepruar edhe një prirje tjetër e kundërt me ballkanizmin: integrimi i etnive më të vogla në etni më të mëdha. Në të vërtetë, diferencimi i parë i popujve sllavë shkonte ndesh me procesin e shkrirjes së fiseve të mëdha rrënjëse të Ballkanit, proces që përfundoi pikërisht në kohën e dyndjeve sllave, gjatë shek. VII, me daljen në skenën e historisë të tre popujve të veçantë: grekëve në jug, shqiptarëve në perëndim dhe rumunëve në lindje të gadishullit, këta të fundit të ndarë prej dy popujve të tjerë nga sllavët, që kishin zënë një brez të gjerë nga Adriatiku në Detin e Zi¹. Prirjet integruese mbetën një karakteristikë e përhershme e këtyre tre popujve, të cilët, edhe kur faktori i jashtëm i ka ndarë, si në rastin e shqiptarëve dhe rumunëve, që ky mijëvjeçar i gjen të ndarë secilin në njësi të ndryshme politike, të cilat, të paktën në planin kulturor, synojnë të afrohen dhe jo të largohen nga njëra-tjetra.

Në çdo rast, ajo që ka ndodhur në fushën politike është reflektuar edhe në fushën kulturore, në religjion e në gjuhë. Për të krijuar identitetin politik, elitat sunduese të njësive të dala nga procesi i diferencimit kanë synuar të përdorin çdo mjet të mundshëm, duke filluar nga gjuha e deri te besimi. Ajo që i është nënshtruar më shumë kësaj ndërhyrjeje të faktorit ideologjik dhe fetar dhe ku këta faktorë kanë pasur më shumë sukses për krijimin e identiteteve të reja, ka qenë gjuha.

Po të shohim gjendjen para se gjuhët e Ballkanit t’i nënshtroheshin standardizimit, dmth. para krijimit të shteteve të pavarura, do të vërejmë që gadishulli ynë, ndryshe nga pjesa tjetër e Europës, shquhet për homogjenitet gjuhësor. Për gjuhët sllave një gjë të tillë e ka vënë në dukje studiuesi i gjuhëve të Ballkanit V. Fridmani, i cili vëren se shumica e dërrmuese e gjuhëve sllave të jugut formojnë një kontinuum, duke filluar nga Kroacia e duke vijuar deri në Greqinë Veriore dhe në brigjet bullgare të Detit të Zi. “Në çdo pikë të këtij kontinuumi, – shkruan ai, – folësit e zonave fqinje e kuptojnë njëri-tjetrin. Me rritjen e largësisë midis pikave rriten edhe dallimet dialektore, ndonëse jo në të njëjtën shkallë... Në rrethana të tilla, përcaktimi i gjuhës bëhet duke u mbështetur në kritere të tjera, si kriteri i vetidentifikimit etnik apo fetar, ose kufijtë gjeografikë a politikë të zgjedhur si përcaktues për arsye jashtëgjuhësore”².

Kështu, po të lëmë mënjane sllovenishten, në gjithë territorin e ish-Jugosllavisë, që sot ndahet midis Serbisë, Kroacisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi, fliten tri dialekte: *ikavian*, *jekavian* dhe *ekavian*, që dallohen midis tyre nga mënyra se si shqiptohet zanorja *ě* (*jat’*). Kufijtë e këtyre dialekteve nuk përputhen aspak me kufijtë e shteteve që përmendëm dhe të gjuhëve standarde të tyre, por i përshkujnë ato sipas izoglosash me drejtim veri-jug, duke bashkuar pjesë shtetesh të ndryshme. Po ashtu, edhe bullgarishtja e maqedonishtja nuk janë tjetër veçse dy gjuhë standarde të ngritura e para mbi dialektin lindor dhe e dya mbi

dialektin perëndimor të bullgarishtes, të cilët zënë fill aty rreth shek. XIII mbi bazën e dy traditave letrare fetare: të Sofjes dhe të Ohrit.

Edhe gjuhët e popujve rrënjës të Ballkanit kanë gjithashtu një minimum dialektesh: rumanishtja – dakorumanishten dhe arumanishten, të formuara si rrjedhim i ndarjes së pasardhësve të dakëve nga brezi sllav; shqipja – gegërishten e toskërishten; dhe greqishtja dialekte që u përgjigjen pak a shumë tri njësisve gjeografike kryesore të Greqisë: Greqia kontinentale, Peloponezi dhe Kreta me ishujt e Jonit.

Në qoftë se homogjeniteti i gjuhëve të folura sllave mund të shpjegohet me moshën relativisht të re të tyre, një gjë e tillë nuk mund të thuhet për gjuhët e tjera të Ballkanit. Sikurse është vënë në dukje nga studiues të ndryshëm, faktori kryesor përgjegjës për homogjenitetin gjuhësor të gadishullit tonë deri në prag të krijimit të shteteve të pavarura është faktori politik. Pushtimi romak përshpejtoi procesin e shthurjes së bashkësive fisnore të Ilirisë, Greqisë e Dakisë dhe krijimin prej tyre të popujve shqiptar, grek e rumun, duke ndikuar pozitivisht në homogjenizimin e këtyre popullsive dhe të gjuhëve të tyre. Po edhe pas rënies së Romës, në Ballkan nuk ndodhi si në Perëndim, ku u krijuan principata të panumërta që ndikuan në ndarjen e gjuhëve neolatine e gjermanike në dialekte të shumta dhe në largimin e tyre deri në atë shkallë sa bartësit e dialekteve të një gjuhe të mos merren vesh midis tyre, si në Itali, Gjermani, Spanjë, Angli etj. Në Ballkan, zhvillimi i feudalizmit në trajtën klasike, që do të kishte shpurrë në lindjen e shumë dialekteve dhe në largimin e tyre, u pengua nga sundimi bizantin dhe më pas otoman. Duke u përfshirë për gati dy mijë vjet në suazën e perandorive të mëdha, trevat e këtij gadishulli u përfshinë në një *pax balcanica*, që shprehej në mungesën e kufijve dhe, rrjedhimisht, në lirinë e lëvizjes brenda hapësirave të perandorisë. Lëvizja dhe komunikimi i lirë i folësve të dialekteve të ndryshme të një gjuhe pati si pasojë të drejtpërdrejtë ruajtjen e afërsisë midis këtyre dialekteve. Pikërisht, me ndikimin unifikues të faktorit politik shpjegohet homogjeniteti gjuhësor i Ballkanit, të paktën gjer në krijimin e shteteve të pavarura³.

Me shembjen e Perandorive Austro-Hungareze dhe Otomane, popujt e Ballkanit fituan pavarësinë dhe krijuan shtetet e tyre kombëtare. Procesi i formimit të shteteve kombëtare në Ballkan, si kudo në botë, karakterizohet nga lëvizje unifikuese në të gjitha fushat: politike, ekonomike, fetare e kulturore. Dhe e para që i nënshtrohet ndërhyrjes unifikuese është gjuha, si mjeti pa të cilin komunikimi midis gjymtyrëve të ndryshme të kombit është i vështirë, në mos i pamundur të realizohet.

Për historinë gjuhësore të shteteve ballkanike, sikurse në planin politik, janë karakteristike dy procese të kundërta: planifikimi dhe riplanifikimi. Procesi i parë është i përbashkët për të gjitha gjuhët kombëtare të gadishullit, kurse procesi i dytë, i riplanifikimit, vetëm për gjuhët sllave. Thelbin e planifikimit gjuhësor e përbën standardizimi i gjuhës, që synon krijimin e një mjeti komunikimi të përbashkët dhe të pranuar nga të gjithë, për të cilin kanë nevojë veçanërisht shkolla dhe administrata dhe pa të cilin kombi nuk siguron dot unitetin e nevojshëm si njësi gjeografiko-politike.

Ndër funksionet e gjuhës, më kryesoret janë funksioni pragmatist, apo zyrtar, dhe funksioni dallues, apo kombëtar, të cilat sociolinguisti i njohur amerikan Joshua Fishman i quan përkatësisht funksion *nacionist* dhe funksion *nacionalist* të gjuhës⁴. Në funksionin *nacionist*, të cilin e përmbush edhe gjuha zyrtare, gjuha vlerësohet më fort nga pikëpamja e nevojave praktike të qeverisjes dhe të edukimit në një shtet kombëtar: për nacionizmin zgjedhja më e mirë si gjuhë zyrtare është gjuha që i përmbush më mirë dhe me kosto sa më të ulët këto nevoja, qoftë kjo edhe një gjuhë e huaj. Në funksionin *nacionalist*, që e përmbush vetëm gjuha standarde, gjuha shihet si tipar themelor i kombit, duke kryer njëherazi funksione bashkuese dhe dalluese. Prandaj "nacionalizmi përpiket në mënyrë të vetëdijshme të krijojë një gjuhë letrare kombëtare moderne, autentike dhe unifikuese, e cila të përdoret atje ku më parë janë përdorur vetëm variante rajonale dhe sociale"⁵.

Në thelb, gjuhët standarde duhen kuptuar si konstrukte deri në njëfarë mase artificiale, të krijuara nga forca politike qendërsynuese (centripete) që kanë si synim të ngrenë dhe të mbrohtësojnë kombet⁶. Zgjedhja e variantit që vihet në bazë të gjuhës standarde bëhet duke u mbështetur herë në faktorë gjuhësorë e herë në faktorë jashtëgjuhësorë dhe, në këtë rastin e fundit, mund të jetë krejt arbitrare, e imponuar nga rrethana të veçanta.

Edhe në krijimin e gjuhëve standarde të Ballkanit janë ndjekur po këto rrugë: diku është ngritur në normë idioma lokale e njësisë që ka krijuar shtetin e vet, diku është zgjedhur njëri nga dialektet e shkruara, diku kjo zgjedhje është bërë duke shkruar dy tradita letrare të ndryshme. Para bashkimit në mbretërinë serbo-kroato-slllovene, të tre popujt kishin gjuhët e veta letrare: slllovenishtja letrare ishte kodifikuar më herët, në fund të shek. XVI, mbi bazën e njërit prej dialekteve të saj që ruante tipare të kohës së Reformës; Serbia dhe Kroacia, ndonëse me dialekte të përbashkëta, për shkak të dallimeve kulturore dhe politike (Kroacia vend katolik nën Perandorinë Hungareze, kurse Serbia vend ortodoks nën Perandorinë Otomane) krijuan dy variante letrare që dallonin më shumë nga alfabetet, të cilat në shek. XIX u kthyen në gjuhë standarde: kroatishtja me rrugë evolucionare kryesisht nëpërmjet purifikimit të leksikut; kurse serbishtja me rrugë revolucionare, nëpërmjet kodifikimit të gjuhës së shkruar nga Vuk Karaxhiçi, që vuri në bazë të saj dialektin shtokav, mbizotërues në Serbi.

Qysh nga ajo kohë, këto dy variante letrare të së njëjtës gjuhë kanë njohur një periudhë afrimi, që u arrit më 1850 me marrëveshjen e Vjenës midis dijetarëve kroatë dhe serbë, ku u pranua se serbishtja dhe kroatishtja ishin një gjuhë e vetme, që u quajt serbo-kroatishite, e mbështetur në dialektin shtokav, që flitej në Hercegovinën Lindore dhe në Serbi, por me shqiptim jekavian, që ishte dialekti mbizotërues në Kroaci. Bashkëjetesa e dy varianteve të standardit gjuhësor serbo-kroat vijoi deri në prag të shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Ky riplanifikim ngjante nga qëllimet me planifikimin e mëparshëm të secilit prej varianteve në atë që qëllimi i tij ishte krijimi i një gjuhe standarde me bazë më të gjerë.

Për sa i përket bullgarishtes, në shek. XIX u vunë re dy prirje të kundërta. Intelektualët maqedonas ishin për një gjuhë letrare bullgare të bazuar në dialektet maqedonase ose për një kompromis dialektor bullgaro-maqedonas. Megjithatë, në Bullgari, ata që ishin të interesuar për këtë problem, këmbëngulnin që si gjuhë letrare të pranohej pa kompromis dialekti i tyre lindor. Si rrjedhim i mospajtit, dy traditat letrare të së njëjtës gjuhë shërbyen si bazë e dy gjuhëve standarde të ndryshme: tradita e Sofjes si bazë e bullgarishtes standarde (shek. XIX), kurse tradita letrare e Ohrit në bazë të maqedonishtes standarde (1945)⁷.

Në rastin e këtyre dy gjuhëve standarde kemi një planifikim gjuhësor tipologjikisht të ndryshëm nga planifikimi i serbo-kroatishtes: mbi bazën e dialekteve të së njëjtës gjuhë, u krijuan dy gjuhë standarde të ndryshme, dmth. planifikimi shpuri në largimin e degëve të të njëjtës trung. Kjo gjë ka vështirësuar deri në njëfarë mase bashkëpunimin midis Maqedonisë dhe Bullgarisë, pasi bullgarët, që e shohin maqedonishten si një dialekt të bullgarishtes, e kanë të vështirë të pajtohen me idenë e dy gjuhëve të ndryshme.

Pra, çintegrimi përbën karakteristikën kryesore të riplanifikimit gjuhësor në vendet sllave të Ballkanit. Kjo prirje u mbështet ligjërisht nga kushtetuta e vitit 1974, e cila njihte të drejtën e çdo populli ose kombi të përdorte gjuhën e vet në nivel republikan dhe rajonal. Si rrjedhim, Republika e Kroacisë, e Bosnjë-Hercegovinës dhe Mali i Zi deklaruan “idiomat e gjuhësore standarde” të tyre si gjuhë zyrtare në territoret e veta, ndonëse duke i quajtur variante të standardit të vetëm serbo-kroat. Me çintegrimin e republikës Federale Jugosllave, kjo prirje është thelluar edhe më shumë. Luftërat dhe konfliktet e armatosura në territoret e ish-Jugosllavisë u pasqyruan në politikat gjuhësore dhe në përpjekjet për planifikim gjuhësor me qëllim afirmimin e katër gjuhëve të reja standarde: kroatishtes, serbishtes, bosnjakishtes dhe gjuhës malazeze. Për këtë të fundit, njohësit e situatës gjuhësore në ish-Jugosllavi patën vërejtur se “lindja e një gjuhe standarde malazeze nuk ka ndodhur, por kjo do të varet para së

gjithash nga zhvillimet politike të cilat do të përcaktojnë nëse Mali i Zi do të bëhet ose jo një shtet i pavarur⁸. Me fitoren e referendumit për shkëputje, në këtë njësi politike po krijohen kushtet edhe për shkëputjen gjuhësore.

Për secilën nga këto gjuhë, planifikuesit gjuhësorë janë shumë të zënë, duke ndryshuar drejtshkrimin, duke krijuar fjalë të reja, duke përgatitur fjalorë, manuale etj.; ata me qëllim i theksojnë, madje i shpikin dallimet midis atyre që sot quhen serbishte, kroatishte, bosnjakishte dhe malazeze. Në këtë mënyrë, “funksioni separatist i gjuhës ka arritur në përmasa pothuajse absurde”⁹ dhe në të ardhmen kjo politikë duket e pakthyeshme, meqenëse planifikuesit e gjuhës “janë ngarkuar me detyrën e krijimit të barrierave të reja të komunikimit, në vend që të lehtësojnë kuptimin e ndërsjellë” midis qytetarëve të këtyre vendeve, që dikur kishin një gjuhë standarde të përbashkët¹⁰.

Ajo që e vështirëson punën e planifikuesve gjuhësorë në njësitë politike që kanë dalë nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë është se as kufijtë dialektorë, as kufijtë etnikë dhe as kufijtë shtetërorë nuk përputhen. Si rrjedhim, njerëzit që jetojnë në një pjesë të një shteti mund të flasin në një mënyrë që afron më shumë me gjuhën standarde të shtetit tjetër. Për këtë arsye, mbetet të shihet se sa planifikimi gjuhësor në këto shtete do ta vështirësojë komunikimin midis këtyre qytetarëve të tyre.

Në teorinë e planifikimit gjuhësor, gjuhët që formohen si rrjedhim i largimit të varianteve të saj njihen me emrin *gjuhë standarde policentrike*, me të cilin duhen kuptuar rastet kur një gjuhë standarde përdoret në dy variante në një a më shumë vende. Sipas gjuhëtarit gjerman Heinz Kloss, të cilit i takon ky term, gjuhë standarde policentrike kemi kur variantet rrjedhin nga largimi në hapësirë, si p.sh. anglishtja britanike dhe anglishtja amerikane; në rastet kur “rrethanat politike kanë shpërurë në zhvillime të pavarura të dy varianteve të së njëjtës gjuhë”, si serbishtja dhe kroatishtja, rumanishtja dhe moldavishtja, bullgarishtja dhe maqedonishtja etj.; si dhe në rastet e atyre “bashkësive gjuhësore që ndodhen ende në fazën fillestare të standardizimit”, si *shqiptarët, baskët dhe kurdët*¹¹. Në tipologjinë e përpunuar nga Kloss-i, gjuhët policentrike të krijuara si rrjedhim i largimit në hapësirë janë të tipit *Abstand*, kurse gjuhët e krijuara me anë të kultivimit të tipit *Ausbau*¹².

Parë në dritën e kësaj tipologjie, gjuhët e sotme standarde sllave që kanë dalë nga shpërbërja e serbo-kroatishtes – serbishtja, kroatishtja, bosnjakishtja dhe gjuha malazeze – si edhe maqedonishtja e bullgarishtja janë të gjitha gjuhë të tipit *Ausbau*, dmth. të krijuara me anë të planifikimit apo të riplanifikimit gjuhësor, që ka pasur si synim krijimin e gjuhëve standarde nga e njëjta gjuhë për t’i bërë bartësit e tyre ta ndiejnë veten të largët me njëri-tjetrin, pra për t’i shërbyer paradigmës së ballkanizimit.

Një pamje krejt tjetër na paraqitin gjuhët e tre popujve më të vjetër të Ballkanit, të cilat kanë njohur vetëm prirje integruese që me fillimin e lëvizjeve nacionaliste, duke u kurorëzuar me krijimin e një gjuhe standarde për secilin vend. Nga këto, rumanishtja si gjuhë standarde është njësuar që në shek. XIX. Edhe në Moldavi, megjithëse kjo për një kohë të gjatë qe pjesë e Perandorisë Ruse e pastaj Sovjetike dhe planifikimi gjuhësor i kryer nga sovjetikët synonte ta ndante përfundimisht nga Rumania duke e shkruar idiomën moldave me shkronja cirilike dhe duke e quajtur atë gjuhë sllave, pas shpalljes së saj shtet i pavarur përdoret gjuha standarde rumune. Megjithatë, në kushtetutën e Moldavisë të vitit 1994 thuhet se gjuhë standarde e këtij vendi është moldavishtja, gjë që mund të shihet (të paktën nga emërtimi) si një prirje për largim nga tradita integruese që është tipike për Rumaninë.

Situata gjuhësore e Greqisë që nga koha e Revolucionit Grek e deri në çerekun e fundit të shek. XX është karakterizuar nga diglosia, dmth. bashkekzistenca e dy varianteve të shkruara të së njëjtës gjuhë: “kathareusa”, si variant i “lartë”, me prirje puriste dhe arkaizuese, i përkrahur nga shteti, dhe “dhimotiqi”, si variant “i ulët” që mbështetej në gjuhën e folur të popullit. Katharuesa mbizotëroi deri më 1976, kur parlamenti grek pranoi

njësëri variantin dhimotiqi si gjuhë standarde të vendit¹³. Pra, edhe në Greqi vërehet prirja integruese, që u kurorëzua me pranimin e një gjuhë standarde.

Siç u vu në dukje më sipër, H. Kloss-i shqipen e fut në radhën e gjuhëve policentrike, pasi, në kohën kur është botuar shkrimi i tij, në vendin tonë përdorehin njëherazi dy variante: varianti letrar tosk dhe gegërishtja në dy-tri tri variante. Pra, ashtu si në rastin e Greqisë para 1976-ës, edhe në Shqipëri para Kongresit të Drejtshkrimit kemi pasur një gjendje diglosie. Të dyja dialektet kishin një status të njëjtë si gjuhë e letërsisë dhe e shtypit, por të ndryshëm për sa i takonte funksionit zyrtar: toskërishtja gëzonte statusin e gjuhës zyrtare, dmth. ishte variant i “lartë”, në Shqipërinë politike; kurse gegërishtja gëzonte të gjitha atributet e një gjuhë në krahinën autonome të Kosovës të ish-Jugosllavisë. Kjo gjendje vijoi deri më 1968, kur Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e shpalli variantin letrar tosk gjuhë letrare të Kosovës dhe të trojeve shqiptare në Jugosllavi. Në këtë mënyrë, varianti tosk fitoi në këto troje, më parë se në shtetin amë, statusin e gjuhës standarde. Që nga ajo kohë gegërishtja erdhi duke e humbur statusin e saj edhe në Shqipërinë politike për të ardhur te Kongresi i Drejtshkrimit, që i dha fund lëvrimit të saj.

Pra, ashtu si për rumanishten e greqishten, edhe për shqipen planifikuesit gjuhësorë kanë synuar afrimin e folësve të dialekteve të ndryshme, duke ndërtuar një gjuhë standarde me bazë të gjerë. Kjo përbën prirjen kryesore të zhvillimeve gjuhësore në këto tri vende, që është e kundërt me prirjen qendërlarguese (centrifuge) të planifikimit gjuhësor të gjuhëve sllave të gadishullit. Kjo do të thotë që edhe në gjuhët e Ballkanit kanë vepruar dy prirjet e vërejtura në fushën e zhvillimeve politike: njëra integruese, e kurorëzuar me krijimin e varianteve letrare dhe të gjuhëve standarde me bazë të gjerë, dhe tjetra çintegruese, që ka shpër në riplanifikim gjuhësor, dmth. në braktisjen e gjuhëve standarde ekzistuese dhe në krijimin e gjuhëve të reja standarde.

Nga këto dy prirje, riplanifikimi gjuhësor që synon shprishjen e një gjuhë standarde dhe krijimin e kufijve të rinj gjuhësorë atje ku nuk ka pasur të tillë ose ku këta kufij kanë qenë relativë, duhet vlerësuar si një dukuri që e kthen një bashkësi gjuhësore shumë prapa, pasi ngre barriera artificiale komunikimi midis folësve të së njëjtës gjuhë, por edhe shoqërohet me pasoja negative në fushën kulturore dhe ekonomike. Si i tillë, ky lloj planifikimi që shkon kundër frymës së përgjithshme të relativizimit të kufijve, është joproduktiv.

¹ L. S. Stavrianos, *The World to 1500 (a global history)*, Englewood Cliffs, N.J., 1970, p. 224.

² V. A. Friedman, *Language Policy and Language Behavior in Macedonia: Background and Current Events*, në “*Language Contact, Language Conflict*”, ed. by Eran Fraenkel and Christina Kramer. Peter Lang: New York, 1993.

³ Shih ndër të tjerë edhe A.-F. Christidis, *The modern Greek language and its history*, The Greek Language, Athens, 1996, p. 73.

⁴ J. A. Fishman, *Nationality-Nationalism and Nation-Nationism*, në J. A. Fishman, Ch. Ferguson, J. das Gupta, *Language Problems of Developing Nations*, New York, 1968, f. 39-51.

⁵ R. Fasold, *The Sociolinguistics of Society*, Oxford/New York, 1984, f. 5.

⁶ M. Czerwinski, *Language planning and lexical networks in Croatia*, NET CULTURE SCIENCE, 2004, p. 129.

⁷ V. A. Friedman, *Language Policy and Language Behavior in Macedonia...*, art. i cit.

⁸ R. D. Greenberg, *Language and Identity in the Balkans*, Oxford, Oxford University Press, 2004, p. 167.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty, p. 13.

¹¹ H. Kloss, *Abstand languages and Ausbau languages*, *Anthropological Linguistics*, 1967, vol. 9, p.31.

¹² Po aty, p. 29-30.

¹³ A. Frangoudaki, *On Greek Diglossia: the Ideological determinants of a Long-Standing Social Conflict over language*, në “*The Greek Language*”, Athens, 1996, p. 83–86; A. Ph. Christidis, *The Modern Greek Language and its History*, në “*The Greek Language*”, Athens, 1996, p. 71–74.